



REPUBLIKA E KOSOVES REPUBLIKA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVO	
AGJENCIJA KUNDER KORRUPSIONIT AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE ANTI-CORRUPTION AGENCY	
Dep.	20/DPK
Dep.	Br Prot.
Dep.	Prot No.
Nr. Ifaq	01-3066/14
Broj stranica	02
Nr. pages	
PRISHTINE	



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

**AGJENCIJA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE
ANTI - CORRUPTION AGENCY**

Në mbështetje të nenit 11 (parografi 1.1), nenit 5 (parografi 1 pika 1.5), nenit 18 (parografi 10 dhe 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, si dhe nenit 19 (parografi 11) të Rregullores nr. 01/2014 së Punës të Agjencisë kundër Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë kundër Korrupsionit me datë 03.09.2014, mori:

V E N D I M

I. Mbylllet rasti me nr. AKK-03-2169/14, për z. Nuhi Llugaxhiu, Drejtor për Kulturë, Rini, Sport dhe Mërgat në Komunën e Therandës (Suharekës), për shkak se zyrtari i lartë publik ka shmangur gjendjen e konfliktit të interesit në të cilën ndodhej.

II. Rasti mund të rihapet në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja.

A r s y e t i m

Rasti i hapur nën dyshimin e bazuar për Konflikt Interesi në Ushtrimin e Funksionit Publik për zyrtarin e lartë, z. Nuhi Llugaxhiu, Drejtor për Kulturë, Rini, Sport dhe Mërgat në Komunën e Therandës (Suharekës), dhe njëkohësisht, person i autorizuar në një biznes privat, është trajtuar sipas procedurës së paraparë në Ligjin Nr. 04/L-051 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik.

Në rastin e lartëpërmendor, zyrtari i lartë z. Llugaxhiu është hetuar për situatë të konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik, për të cilin është dyshuar se ushtron dy funksione të papajtueshme, si Drejtor për Kulturë, Rini, Sport dhe Mërgat në Komunën e Therandës (Suharekës) dhe si person i autorizuar në biznesin privat N.Sh. "Express".

Zyrtari i lartë, fillimisht është njoftuar me një shkresë zyrtare nga Agjencia kundër Korrupsionit, për fillimin e shqyrimit të gjendjes së mundshme të konfliktit të interesit, pas pranimit të kësaj shkresë, ai është informuar për gjendjen në të cilën ndodhet si dhe ndryshimet të cilat duhet ti bëj, për të parandaluar situatën e mundshme të konfliktit të interesit.

Zyrtari i lartë z. Llugaxhiu ka pranuar rekomandimin e Agjencisë, për të bërë ndryshimet e nevojshme në Agjencinë për Regjistrimin e Bizneseve në Kosovë, për të shmangur gjendjen e mundshme të konfliktit të interesit.

Duke parë se procesi i ndryshimeve po zgjatë Agjencia i ka bërë shkresën e dytë sipas procedurës ligjore që quhet “njoftimi paralajmëruesh”, me të cilin zyrtarit të lartë i është bërë e qartë se duhet të shmanget situata e konfliktit të interesit brenda afatit të caktuar, përndryshe do të pasojnë masat tjera sanksionuese të parapara me ligj.

Ndërkohë, zyrtari i lartë z. Llugaxhiu ka dërguar në Agjenci shkresen zyrtare të lëshuar nga Agjencioni për Regjistrimin e Bizneseve në Kosovë (DPKI.03- 3033/14) në të cilën vërtetohet se i njëjtë është larguar nga të qenurit person i autorizuar në biznes privat.

II. Në mbështetje të nenit 18 (paragrafi 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korruptionit, Agjencia mund të rihap rastin në çdo kohë nëse paraqiten rrethana të reja.

Andaj u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtarit të lartë publik
- Drejtorit të DPK- së
- Z./z. (zyrtari përgjegjës)

